

“KORRUPSIONI”- KËSHTJELLË RËRE, DILEMË MES FENOMENEVE TË NJË VENDI NË ZHVILLIM DHE GJENEZËS HUMANE

nga Miranda HAXHIA – Audituese e Lartë,
botuar në gazetën gazetën “55”, më 16 maj 2015.



“Korrupsioni” është një fenomen që njihet që nga kohët e lashta por si term është i paqartë dhe hap shumë tema për diskutim dhe debat, shpesh herë merr kuptime të ndryshme dhe të pa përcaktuara, por që në fund të fundit përkufizohet si shpërdorim i pushtetit publik për përfitime personale nga nëpunësit publikë, marrëveshjet e fshehta në prokurimet publike ose përvetësimi i fondeve publike, apo siç përkufizohet ndryshe nga filozofia si *“një e keqe, jo sepse paratë dhe përfitimet ndryshojnë dorë apo për shkak të motiveve të pjesëmarrësve, por sepse ai privatizon aspekte të veçanta të jetës publike duke krijuar debate dhe probleme të ndryshme”*.

Korrupsioni është i lidhur me çdo abuzim të pushtetit dhe çdo parregullsi të kryer në një proces vendimmarrjeje, në shkëmbim të një avantazhi të padrejtë.

Gjurmët në veprat e korrupsionit ose siç quhet ndryshe “krimi i bardhë” janë shumë të pakta dhe numri i personave që mund të kenë dijeni është shumë i kufizuar, pra ndodh fenomeni “korrupsion kudo, askush i pafajshëm”.

Korrupsioni mund të ngjitet kudo, asnjë organizëm dhe asnjë institucion nuk është i paprekshëm dhe nuk mund të quhet i “lirë” dhe asnjë institucion që ka përgjegjësi publike, nuk mund të konsiderohet se është i lirë nga llogaridhënia dhe se mund ta shpërfillë atë.

Të parashikosh dhe të përballësh me korrupsionin, është detyrë e përbashkët dhe e pandalshme, një sfidë që duhet fituar nga të gjithë, është sfida e pavarësisë.

Lufta ndaj korrupsionit duhet të bëhet nga të gjithë, në këtë luftë KLSH si institucioni më i lartë i auditit të jashtëm, mishëron në planin strategjik të zhvillimit 2013-2017, si objektivi i tij *“rritjen e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit”*¹. Pikërisht në luftën ndaj korrupsionit, misioni i KLSH ka synim kryesor *“informimin e publikut dhe Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nga nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikën më të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit”*.

Në auditimet e saj të fundit, KLSH tregoi se korrupsioni “kështjellë rëre” shembet para syve tanë, nëse lufta ndaj tij bëhet me intensitet dhe pa

¹ Hyrje nga z. Bujar Leskaj-Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit në botimin “Plani strategjik”.

ndërprerje. Kjo ka bërë që në auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të zbulohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën 19 891 743 lekë nga të cilat 2 370 543 lekë do të kthehen nga përfituesit pa të drejtë të kësaj shume.

Abuzimet në tenderat me fonde publike dhe kryesisht në tenderat me objekt *“Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I. T. B. Berlin”*, me vlerë kontrate **7 918 800 lekë**, *“Prodhimi i materialeve promociionale në kuadër të vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri”*, me vlerë kontrate **6 102 000 lekë** dhe *“Prodhimi i materialeve promociionale (gadgets, give, away)”*, me vlerë kontrate 3 500 400 lekë, tregon për keq menaxhimin e fondeve publike nga menaxheri kryesor i kësaj njësi publike. Gjithashtu abuzime u konstatuan dhe në *marrjen me qira të ambienteve për magazinim për vitin 2014, ku merret një ambient me sipërfaqe prej 700 m²*, e pa justifikuar dhe e pa argumentuar, pasi AKT është akomoduar pranë godinës të Ministrisë së Zhvillimit nga data 01.04.2014, në të cilën përveç ambienteve të zyrave në dispozicion ka në administrim të saj nga momenti i transferimit dhe dy magazina. Për pasojë marrja me qira e këtij ambienti nuk ka qenë efiçente, efiçase dhe ekonomike pasi nuk është magazinuar asnjë artikull referuar dokumenteve të magazinës dhe nuk disponohet hyrja dhe dalja nga institucioni por realizohet nga subjekte private.

Abuzime janë konstatuar dhe në mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin e veprimtarisë së AKT-së, duke paguar qira për stola e tavolina e jo për promovimin e turizmit.

Në këtë aspekt transparenca e plotë e administratave, është objektivi i parë për t'u ndjekur përmes zbardhjes së të dhënave publike dhe informacionit, të cilat lejojnë një kontroll të hapur real të veprimeve të administratës publike nga ana e shoqërisë civile. Jo pak, në drejtim të këtij objektivi ka dhënë ndihmesën e saj KLSH, ku publikimi i raporteve të auditit si dhe marrëveshja me shoqërinë civile në drejtim të rritjes së transparencës ka qenë bashkudhëtare e përbushjes së objektivave të saj institucionale.

Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim merr dhe futja e masave që kanë të bëjnë me integritetin e funksionarëve publikë dhe përhapjen e një kulture të etikës publike, që i bën të gjithë të ndërgjegjshëm nga efektet shkatërruese të korrupsionit dhe keqadministrimit. Nisur nga ky objektivi, KLSH ka bërë kallëzim penal për drejtuesin kryesor të AKT-së duke ndikuar sadopak në ndërgjegjësimin e këtyre funksionarëve publikë që abuzojnë me fondet publike.